



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIC OF KOSOVA



REPUBLIKA KOSOVA
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Datë:	03.11.2025
Referencë:	ZR
Për:	Imri AHMETI, Kryetari Komunës
Nga:	Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM
Kopje:	Diamant Bytyçi, Nënkyetar i Komunës Avni Jashari, Shef i Kabinetit të Kryetarit të Komunës
Lënda:	RAPORTI MUJOR I PUNËS – TETOR 2025

Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në detyrat e përcaktuara sipas Planit Vjetor të Punës për vitin 2025, ju dorëzon:

RAPORTIN MUJOR
TË PUNËS PËR PERIUDHËN RAPORTUESE 01.10.2025-31.10.2025

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese DPUMM- në sektorin e Urbanizmit ka zhvilluar aktivitetet themelore si vijon:

Gjatë kësaj periudhe DPUMM ka trajtuar disa prej lëndëve të pranuar dhe kërkesave të bartura. Gjatë muajit tetor 2025-janë pranuar gjithsejtë 67-kërkesa të natyrave të ndryshme, kurse të bartura nga muaji paraprak kanë qenë 31 lëndë, që në total rezulton të jenë 98 lëndë për shqyrtim. Prej tyre janë trajtuar gjithsejtë 83 kërkesa, 49 të miratuara, 29 të refuzuara, pushim procedure 2 dhe 3 të ceduara. Për shqyrtim në muajin vijues barten 15 lëndë të natyrave të ndryshme.

Statusi i trajtimit të lëndëve të pranuar dhe atyre të bartura është prezantuar në pjesën tabelare.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera DPUMM ka kryer edhe aktivitete të tjera.

Në fushën e shqyrtimit të kërkesave është vazhduar me intensifikimin e angazhimeve për shqyrtimin e tyre brenda afateve ligjore.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesen e taksave sipas kategorive të caktuara. Lidhur me këte janë lëshuar 30 konkluzione për pagesen e taksave. Prej tyre 10 konkluzione për leje ndërtimi, 10 për leje mjedisore komunale, 9 për shëndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimi dhe 1 për leje rrënimi.

Po, ashtu DPUMM ka përgatitur dhe adresuar te palët ftesa për plotësimin e dokumentacionit. Në kuadër të kësaj janë lëshuar 4 ftesa për kompletim të lëndëve. Brenda muajit tetor nuk është pranuar dokumentacioni përkatës për plotësimin e lëndëve nga asnjëra palë të cilave iu ka adresuar ftesa.

DPUMM ka trajtuar një kërkesë për ekspertizë gjyqësore. Kërkesa është proceduar me kohë.

Janë përgatitur dhe dorëzuar të gjitha lëndët tek auditorët e jashtëm për fazen e I-rë të auditimit nga ZKA. Vetëm në këtë periudhë të “testeve kalimthi” janë kërkuar 15 lëndë për auditim.

Janë përgatitur dy raporte për kryerjen e pagesave lidhur me hartimin e projekteve kryesore.

Është trajtuar edhe një kërkesë (faturë) për pagesë për hartim të projekteve por e njehta nuk është pranuar në shumën e kërkuar nga operatori. Për shkak të kësaj, operatori ka inicuar kërkesen për pagesë përmes organit përmbarues. Lidhur me këte, DPUMM ia ka prezantuar të dhënat përkatëse përfaqësuesit ligjor të Komunës.

Është pranuar Vendimi nga MKRS për vendosjen e Janjevës në listen e trashëgimisë kulturore. Po ashtu është pranuar Vendimi dhe lista e objekteve të trashëgimisë kulturore për periudhën 2025/2026 (e përkohshme), ku nga Komuna e Lipjanit përfshihen nën mbrojtje kulturore rreth 35 objekte në lokalitete të ndryshme të Komunës. Në bazë të kësaj, duhet pasur parasysh mbrojtjen e tyre dhe aplikimin e procedurave të veçanta gjatë aktiviteteve zhvillimore.

Aktivitete të tjera janë kryer edhe si:

Është në zbatim e sipër programi për regjistrimin e adresave zyrtare, proces që zbatohet nga AKK. Procesi mbikëqyret dhe mbështetet nga DPUMM.

Aktivitetet themelore për muajin vijues:

Vazhdimi i angazhimeve për shqyrtimin e lëndëve.

Vazhdimi i bashkëpunimit me Drejtoratet relevante në procesin implementues të projekteve komunale.

STATISTIKAT

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët

Tabela 1.

Nr.	Llojet e kërkesave	Të pranuar	Nga periudha e kaluar	Të miratura	Pushim pocedure	Të refuzuar a	Të bartura në sektor të tjerë	Në proces (pritje)
1.	Kushte ndërtimore	6	3	4		4		1
2.	Leje ndërtimi	6	9	9		4		2
3.	Leje rrënimi	3	2	2		1	1	1
4.	Tërheqje lande/dokum.	4	1	4	1			
5.	Akte nga MMPHI- rish.	1						1
6.	Njoftime nga MMPHI	3		3				
7.	MKRS-shqyrtim	1		1				
8.	Informacione urbane	3	2	3		2		
9.	Certifikatë legalizimi /Leje Legalizimi	8	4	1	1	6		4
10.	Legalizimi/ Në listë të pritjes							
11.	Bashkim/ndarje e parcelave	8		4		2		2
12.	Kërkesë për LMK	7	7	9		3		2
13.	Qasje në dokumente	2		2				
14.	Dokumente për një anëtarë komisioni		1	1				-
15.	Ndërrim destinimi		1			1		
16.	Pëlqim për panele solare	3		1		2		
17.	Emërtim rruge	2	1			3		
18.	Ankesë – legalizim	1						1
19.	Dokumente për ekspert gjyqësor	1		1				
20.	Kompensim prone	1					1	
21.	Verifikim prone	1				1		
22.	Kerkese për respektimin e kriterëve për ndërtim	1		1				
23.	MKRS – për Janjeven	1		1				
24.	MKRS –Lista e objekteve të trash.kultur.	2		2				
25.	Kërkesë për dorëz. të projektit në MKRS	1					1	
26.	Kërkesë tjetër	1						1
	Gjithsejtë:	67	31	49	2	29	3	15

Sipërfaqja tokësore për ndërtim, sipërfaqja e ndërtesave dhe destinimi

Tabela 2.

Nr.	Kategoria e ndërtimit	Sipërf. Tokës – m2	Sip.ndëtesës- m2	Destinimi	Vendi
1.	II	2001	9597 B 800 A	NLB	Lipjan
2.	II	2059	6281.03 B 622.04 A	NLB	Lipjan
3.	II	3700	7484.9 B 636.3 A	NLB	Lipjan
4.	II	1420	2982.7 B 548 A	NLB	Lipjan
5.	II	5290	5440.27 B 701.65 A	NLB	Lipjan
4.	II	2606	1200 A	Afarist	Banullë
	II	1550	849.62 A	Afarist	Konjuh
	I	1288	397.8 A	Afarsit	Sllovi
	I	500	311.67	Shtëpi	Lipjan
Gjithsejtë		20414	37852.98		

Tokë e shfrytëzuar vetëm për banim = 500 m2 me gjithsejtë ndërtim prej 311.67 m2. Kurse tokë e shfrytëzuar vetëm për afarizëm = 5444 m2 me gjithsejtë ndërtim për afarizëm prej 2447.42 m2 dhe tokë e shfrytëzuar për banim dhe afarizëm në qytet 14470 m2 në të cilën janë ndërtuar 31785.9 m2 për banim dhe 3307.99 m2 për afarizëm (NLB).

Në bazë të analizës së ndërtimeve sipas destinimit del se gjatë muajit tetor 2025 - 84.79% e hapësirave të ndërtuara janë destinuar për banim, kurse vetëm 21% e tyre janë destinuar për afarizëm. Ky fakt fletë se investimet direkte në fushen e ndërtimeve për qëllime të zhvillimit ekonomik janë tejet të vogla krahasuar me ato për qëllime banimi. Po ri- theksojmë se sipas të dhënave nga ASK nga regjistrimi i popullsisë dhe pasurisë të zhvilluar gjatë vitit 2024, në Komunën e Lipjanit 35.3% e njësive banesore (shtëpi dhe banesa) janë të pa shfrytëzueshme.

Buxheti:

Gjatë muajit tetor 2025 të hyrat nga kategoritë e ndryshme nga fusha urbane janë relativisht të larta, meqenëse janë lëshuar disa leje ndërtimi (7 leje te kategorisë së II-të dhe 2 leje të kategorisë së I-rë).

- Të hyrat për leje ndërtimore janë realizuar në shumë prej:.....231,832.64€
 - Të hyrat për ndërrimin e destinimit të tokës në shumë prej:16,262.00€
 - Të hyrat për leje mjedisore komunale janë realizuar në shumë prej.....26,180.69€
 - Të hyrat për legalizimin e ndërtesave pa leje janë realizuar në shumë prej:.....2,839.84€
 Te hyrat për Leje rrënimi janë realizuar në shumë prej113.61€

Shuma totale e të hyrave:277,228.78€

Të dhënat lidhur me të hyrat për muajin tetor 2025 janë pranuar nga sektori i financave në kuadër të Drejtoratit përkatës të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me shpenzimet kemi kryer obligimet ndaj operatorëve ekonomik. Nga kategoria ekonomike “Mallra dhe shërbime” mjete të lira janë rreth 3,000.00€ të cilat mund të shfrytëzohen për nevoja të drejtorateve të tjera.

Për shumën e zotuar për nevoja të Drejtoratit të Administratës, nuk kemi arritur të marrim të dhëna për nivelin e shpenzimeve.

DISKUTIME PUBLIKE:

Gjatë muajit tetor 2025 nuk kemi pasur ndonjë diskutim publik.

SFIDAT:

- Mungesë e theksuar e stafit në punë për shkak të pushimeve mjekësore;
- Mosplotesimi i dy vendeve të lira të punës.